



Republika e Kosovës  
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 951/2021  
Datë: 28 dhjetor 2021

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 dhe nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve si dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve si dhe sipas Raportit të Panelit Hetimor AD.nr.10/2021, të datës 26 nëntor 2021 të plotësuar më datë 22 dhjetor 2021, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj prokurores Lumturije Hoxha, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 28 dhjetor 2021, në seancën e këshillimit dhe votimit morri këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHET** si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor AD.nr.10/2021, i datës 26 nëntor 2021, i plotësuar më datë 22 dhjetor 2021, në rastin disiplinor ndaj Lumturije Hoxha, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm.
- II. **VËRTETOHET** se te prokurorja Lumturije Hoxha, nuk janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, që bien ndesh me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

## Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës më datë 22 shtator 2021, ka pranuar Kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor ndaj prokurores Lumturije Hoxha nga Autoriteti Kompetent, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, z. Agim Kurmehaj, me propozimin që të njëjtës ti shqiptohet masa "Vërejtje jo publike me shkrim" në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më datë 11 tetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka nxjerr nxjerr vendimin me numër KPK/Nr.737/2021 për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.10/2021, ndaj Lumturije Hoxha, prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.

Më datë 26 nëntor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka pranuar Raportin AD.nr.10/2021, me të cilin Paneli Hetimor ka ardhur në përfundim se në veprimet e Lumturije Hoxha, prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë, nuk është vërtetuar se ka kryer shkelje disiplinore që bien ndesh me Ligjin Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror.

Në seancën disiplinore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, të datës 02 dhjetor 2021, pas prezentimit të Raportit AD.nr.10/2021 nga Kryesuesi i Panelit Hetimor, prokurorja Hoxha ka deklaruar se, citim: *"Unë e kam përpiluar një shënim zyrtar, qysh i kam treguar (kallxuar) Kryeprokurorit Agim Kurmehaj, lidhur me lëshimin e afatit të kësaj anekse, po t'ua them të drejtën me plot përgjegjësi, unë e di që e kam dorëzuar ankesën me kohë, e kam pyet zyrtaren, unë e kam dorëzuar me kohë"*.

Po ashtu, prokurorja Hoxha, ka prezantuar provën materiale nga libri i dorëzimit - pranimit, ku dëshmohet se aneksa nga zyrtarja e cila punon në zyrën e të njëjtës është dorëzuar tek referentja e shkrimores [redacted] më datë 06.04.2021.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në seancën disiplinore të mbajtur më datë 02 dhjetor 2021, pas prezentimit të Kryesuesit të Panelit, dëgjimit të subjektit të hetimit dhe analizimit dhe shqyrtimit të Raportit AD.nr.10/2021, të datës 26 nëntor 2021, me shumicë të votave, ka vendosur ta kthej Raportin në plotësim gjegjësisht për grumbullimin e fakteve dhe provave shtesë, marrjen e deklaratës së [redacted] dhe stafit mbështetës administrativë i cili merret me pranim - dorëzimit të ankesës/ave prej prokurorit/es tek dorëzuesi në gjykatë.

Më datë 24 dhjetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Paneli Hetimor, ka pranuar Raportin e plotësuar AD.nr.10/2021, të cilit raport i janë bashkangjitur provat shtesë siç janë: deklaratat e [redacted] deklaratat e [redacted] Referente në P. Th. në Pejë, deklaratat e [redacted] Bashkëpunëtore Profesionale në zyrën e prokurores Hoxha, subjektit të hetimit disiplinor, deklaratat e [redacted] në P. Th. në Pejë, si dhe kopjet nga libri i dorëzimit - pranimit të ankesës prej Bashkëpunëtore Profesionale me punë në zyrën e prokurores Hoxha të [redacted] dhe dorëzuesi i P. Th. në Pejë.

Në seancën e mbajtur më datë 28 dhjetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas prezentimit të Raportit të plotësuar, prezentimit të Kryesuesit të Panelit mbi të gjeturat, deklaratave të cekura si më lartë, si dhe bazuar në shkresat e lëndës ka vërtetuar se prokurorja Lumturije Hoxha ka përpiluar ankesën me datën 05 prill 2021 dhe ka kërkuar nga Bashkëpunëtorja [redacted] më datë 06 prill

2021, të dorëzon ankesën. Nga [REDACTED] është konfirmuar se ankesa është dorëzuar me kohë gjë që është vërtetuar edhe nga deklarata e prokurores Hoxha, deklarata e zyrtares [REDACTED] deklarata e referentes [REDACTED] e dhënë në seancën dëgjimore të datës 09.12.2021, nga regjistri që e mban zyrtarja Kuqi dhe prova nga libri intern i dorëzim - pranimit të ankesës (e siguruar në seancën dëgjimore të datës 09.12.2021), në të cilën shihet qartë se ankesën prokurorja Hoxha e ka dorëzuar te referentja [REDACTED] më datë 06.04.2021, e cila është vërtetuar përmes nënshkrimit të prokurores dhe referentes, si dhe datës së dorëzim - pranimit në shkrimoren e Prokurorisë.

Po ashtu, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka vërtetuar të gjeturat e panelit hetimor se në veprimet e prokurores Hoxha nuk ishin manifestuar shkeljet e pretenduara disiplinore sepse mos dorëzimi i ankesës me kohë ka rezultuar me lëshime të afatit nga stafi administrativë i Prokurorisë Themelore në Pejë.

Bazuar në të gjeturat si më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, me shumicë të votave vendosi ta aprovoj Raportin e Panelit Hetimor, pasi që me provat e prezentuara është vërtetuar se në veprimet e prokurores, e cila ka qenë subjekt i hetimit disiplinor, nuk janë gjetur elemente të shkeljes disiplinore që bien ndesh me Ligjin Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të vlerësimit të çështjes morri vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtëpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

#### **T'u dërgohet:**

- Z. Agim Kurmehaj, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Pejë;
- Znj. Lumturija Hoxha, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Pejë;
- Arkivit të KPK-së.